



Politika e palëve të interesit

Përmbajta

1. Objektivi	3
2. Përkufizime	3
Objektivi i politikës së palëve të interesuara është:	4
Palët kryesore të interesit	5
3. Fushëveprimi.....	5
4. Përmbajtja e politikës.....	6
Klientët.....	6
Partnerët e biznesit, partneritetet tregtare, furnitorët dhe pjesëmarrësit në treg	7
Punonjësit dhe përfaqësuesit e tyre	7
Investitorët	8
Institucionet mikrofinanciare dhe bankat.....	8
Publiku i gjerë	8
Shtypi, radiot, televizioni dhe mediat online	9
Organizatat e interesit, OJQ-të, opinionistët dhe ekspertët.....	9
Autoritetet publike	10
Qeveria dhe politikanët	10
Përshkallëzimi dhe shkeljet.....	11
Rishikimi.....	11
5. Aprovimi dhe Hyrja në Fuqi	11

1. Objektivi

Kreditimi Rural i Kosovës ka një gamë të gjerë palësh të interesuara dhe të rëndësishme, mbështetja e të cilëve është çelësi i suksesit tonë. Siç përcaktohet edhe nga politika e kodit të mirësjelljes, ne aspirojmë të marrim përgjegjësi dhe të sigurojmë një ndikim për institucionin, shoqërinë, klientët, punonjësit dhe investitorët. Ne e konsiderojmë dialogun si komunikim të ngushtë integral dhe të natyrshëm për operacionet tona. Ne e mirëpresim dialogun me të gjitha palët e interesuara dhe duam të angazhohemi në mënyrë të hapur dhe konstruktive në një perspektivë afatgjatë.

Politika e palëve të interesuara udhëzon proceset e angazhimit të palëve të interesuara dhe përcakton rolet dhe përgjegjësinë për të siguruar fokusin dhe vëmendjen e nevojshme në procesin e angazhimit.

2. Përkufizime

Përkufizimet e mëposhtme zbatohen për termat e përdorur në të gjithë Politikën.

Kreditimi Rural i Kosovës (KRK)

Bordi i drejtorëve (BD)

Objektivi i politikës së palëve të interesuara është:

- Të përshkruajë parimet dhe udhëzimet e përgjithshme për marrëdhëniet me palët e interesuara.
- Sigurimi dialogut me palët e interesuara trajtohet në përputhje me parimet dhe udhëzimet e përshkruara në politikë.
- Politika e palëve të interesit të miratohet nga BD dhe do të përshkruajë rëndësinë e angazhimit të palëve të interesuara.
- Qëllimi i politikës është të drejtojë qasjen e KRK-së për t'u angazhuar me grupe të ndryshme të palëve të interesuara.
- Kanalet e komunikimit që KRK do të përdorë për t'u angazhuar me palë të ndryshme të interesuara (p.sh. takime, raporte, media sociale), rolet dhe përgjegjësitë brenda KRK-së për angazhimin e palëve të interesuara, duke përfshirë stafin e caktuar dhe ekipet e komunikimit.
- Politika e palëve të interesit është bashkërenditur me dokumentet dhe procedurat e brendshme të KRK-së.
- Politika e palëve të interesit do të përkthehet në gjuhët që mund të kuptojnë palët e interesuara dhe do të publikohet në faqen e internetit të KRK-së.

Mosrespektimi i kësaj Politike mund të çojë në masa disiplinore.

Organi Drejtues (menaxhmenti) është organi i një institucioni, i cili emërohet në përputhje me legjislacionin shtetëror dhe procedurat e brendshme të institucionit, të cilët janë të autorizuar të përcaktojnë strategjinë, objektivat dhe drejtimin e përgjithshëm të institucionit që mbikëqyrin dhe monitorojnë vendimmarrjet.

Palët kryesore të interesit

Palët kryesore të interesit identifikohen si individë, grupe dhe organizata që drejtpërdrejt ose indirekt angazhohen dhe ndikohen nga veprimtaria e jonë.

Palët tona kryesore të interesit janë:

- Klientët
- Partnerët e biznesit, partneritetet tregtare, furnitorët dhe pjesëmarrësit në treg
- Punonjësit
- Investitorët
- Institucionet mikrofinancare dhe bankat
- Publiku i gjerë
- Shtypi, Radiot, Televizioni dhe mediat online
- Organizatat e interesit, OJQ-të, opinionistët dhe ekspertët
- Autoritetet publike
- Qeveria dhe politikanët

3. Fushëveprimi

Politika e palëve të interesuara është e rëndësishme për të gjithë punonjësit, veçanërisht ata që angazhohen shpesh me grupet e ndryshme të palëve të interesuara.

4. Përmbajtja e politikës

Parimet e përgjithshme

Palët tona të interesit mbështeten në informacionin dhe deklaratat e bëra nga KKK, dhe komunikimet tona duhet të jenë të sakta dhe të besueshme, të mos mashtrojnë apo të bëjnë keqinterpretime ndaj palëve tona të interesit.

Prandaj, komunikimet me të gjitha palët e interesuara duhet të jenë të sakta, të qarta, të përditësuara dhe të ligjshme, dhe të mos anashkalojnë ose fshehin informacione materiale.

Çdo komunikim ose dialog me palët e interesuara duhet të jenë i argumentuara, dhe për aq sa është e mundur t'i referohen materialit tashmë publik, p.sh., deklaratat e financiare.

- Degët e KKK-së dhe funksionet e grupit janë përgjegjëse për të siguruar dhe dokumentuar që çdo komunikim, i cili devijon ose është jashtë fushës së informacionit të komunikuar publikisht, është nënshkruar nga Eksperti(ët) përkatës për çështjet dhe faktet.
- Degët si dhe funksionet e grupit duhet poashtu të angazhohen për të siguruar qëndrueshmëri dhe mesazhe të përshtatshme të komunikimeve.

Klientët

Në përputhje me politikën e kodit të mirësjelljes, klientët e kënaqur janë baza për rritje afatgjatë, të qëndrueshme dhe profitabile. Klientët tanë janë në qendër të gjithçkaje që bëjmë dhe ne jemi partnerë për të krijuar zhvillim të qëndrueshëm, tani dhe për brezat që do të vijnë.

- Është detyra jonë t'u japim klientëve këshilla të sigqerta dhe të qarta bazuar në situatën dhe ambiciet e tyre individuale si dhe vlerësime të qëndrueshme financiare e të favorshme .
- Ne jemi përgjegjës dhe konstruktiv për klientët që t'i përfshijmë ata në zgjidhjet dhe zhvillimin e produkteve.
- Ne e dimë se mund të bëjmë ndryshime sëbashku me klientët në arritjen e ambicieve të tyre në mënyrën më të qëndrueshme.
- Ne e kemi synim që të jemi një partner i besueshëm dhe t'u mundësojmë klientëve tanë të krijojnë përparim të qëndrueshëm.

Partnerët e biznesit, partneritetet tregtare, furnitorët dhe pjesëmarrësit në treg

Ne bashkëpunojmë në mënyrë proaktive duke synuar të krijojmë vlerë për klientët tanë, partnerët dhe shoqërinë në përgjithësi.

- Ne synojmë të jemi një partner transparent, bashkëpunues dhe i besueshëm, si dhe një përfaqësues i besueshëm dhe i përgjegjshëm për gjithë sektorin.
- Ne bashkëpunojmë me objektiven për të arritur qëllime të përbashkëta për të mirën e klientëve tanë dhe shoqërisë. Ne synojmë të jemi të qasshëm që të ndërtojmë dhe ruajmë marrëdhënie profesionale.
- Ne ecim përpara duke vepruar si një partner i vërtetë afatgjatë, i përkushtuar për të sjellë në jetë idetë dhe ambiciet dhe për të mbështetur përparimin e qëndrueshëm përmes mënyrës të të bërit biznes.

Punonjësit dhe përfaqësuesit e tyre

- Ne synojmë të ndërtojmë një kulturë të mirë me potencial në zhvillimin personal, ku punonjësit lulëzojnë, fuqizohen dhe veprojnë sipas angazhimeve tona kulturore.
- Ne përqafojmë diversitetin dhe jemi të përkushtuar për të promovuar një mjedis pune gjithëpërfshirës dhe për të nxitur dialog produktiv me punonjësit dhe përgjegjësit e tyre.

Investitorët

- Ne i informojmë investitorët, analistët dhe aksionarët, hapur dhe në mënyrë adekuate, me integritet sipas procedurave tona.
- Ne duam të vëmë përvojën tonë të disponueshme për palët e interesit dhe të krijojmë vlerë përmes komunikimit dhe bashkëpunimit.
- Ne synojmë të jemi një partner i hapur dhe transparent për investitorët dhe analistët me qëllim të arritjes së një bazë investitore të qëndrueshme dhe të larmishme.

Institucionet mikrofinanciare dhe bankat

- Ne informojmë institucionet mikrofinanciare dhe bankat hapur, në mënyrë adekuate dhe me integritet.
- Ne duam të vëmë në pah ekspertizën për palët tona të interesit dhe të krijojmë vlerë përmes komunikimit dhe bashkëpunimit tonë.
- Ne synojmë të jemi një partner i hapur dhe konstruktiv për konkurrentët dhe të gjithë parnerët.
- Ne do të punojmë në mënyrë aktive me partnerët e sektorit për të siguruar standardet më të larta të punës.

Publiku i gjerë

- Ne e njohim rolin dhe përgjegjësinë që kemi dhe duam të kontribuojmë në mënyrë aktive në krijimin e progresit të qëndrueshëm në shoqërinë ku jemi pjesë.
- Ne synojmë të jemi të besueshëm, transparent, të arritshëm dhe të komunikojmë në mënyrë të hapur dhe të ndershme.
- Ne synojmë të kemi një shkallë të lartë besimi me publikun e gjerë.
- Ne synojmë të jemi transparent, të qasshëm, dhe të komunikojmë në mënyrë të qartë.

Shtypi, radiot, televizioni dhe mediat online

- Ne e kuptojmë se gazetarët kanë një interesim të veçantë dhe aktiv në mënyrën se si ne e drejtojmë institucionin tonë.
- Ne angazhohemi në dialog të hapur me shtypin dhe mediat e tjera.
- Ne synojmë të jemi të aksesueshëm dhe të ndërtojmë e ruajmë marrëdhënie profesionale me të gjithë bashkëpunëtorët.
- Ne synojmë të ndajmë ekspertizën tonë në mënyrë proaktive për të krijuar sa më shumë vlera për palet.
- Ne duam të jemi një partner i hapur dhe bashkëpunues për gazetarët dhe të gjitha mediat, që të sigurojmë mbulim të drejtë dhe të balancuar.

Organizatat e interesit, OJQ-të, opinionistët dhe ekspertët

- Ne mirëpresim që këto palë të interesuara shoqërore të kenë një interes aktiv në mënyrën se si ne e drejtojmë institucionin tonë dhe vlerësojmë kontributin dhe perspektivat e tyre.
- Ne synojmë të jemi të qasshëm dhe të ndërtojmë e ruajmë marrëdhënie profesionale.
- Ne synojmë të ndajmë ekspertizën tonë për çështjet përkatëse dhe çështje të cilat janë të ndërlidhura këto palë.

Autoritetet publike

- Ne veprojmë me respekt, integritet dhe profesionalizëm duke siguruar që të gjitha informacionet të jenë të sakta dhe të shpërndara në kohën e duhur.
- Ne duam të mbetemi institucion i besueshëm partner konstruktiv në zhvillimin dhe zbatimin e rregullores.
- Ne synojmë të ndajmë ekspertizën tonë për çështjet përkatëse, duke përfshirë p.sh., zhvillimin e politikave.
- Ne angazhohemi në një dialog bashkëpunues me autoritetet për të kuptuar nevojat dhe objektivat e tyre dhe për të ofruar ekspertizën dhe pikëpamjet tona.

Qeveria dhe politikanët

- Ne duam të jemi një partner konstruktiv i nxitur nga një ambicie për të krijuar vlera për shoqërinë, për të pasur një dialog të hapur dhe bashkëpunues dhe për të ofruar ekspertizë në mënyrë transparente.
- Ne jemi të angazhuar në dialogun mbi rregulloren që lidhet me industrinë financiare me fokus të veçantë në ndikimin që do të ketë tek klientët tanë, modelet e biznesit dhe strategjitë.
- Ne synojmë të ndërtojmë dhe mbajmë marrëdhënie profesionale dhe të jemi një partner i qasshëm dhe i besueshëm që ofron informacion të besueshëm për Grupin, sektorin financiar dhe ekonominë në përgjithësi.
- Konkretisht në lidhje me akterët politikë, ne nuk japim kontribute financiare, drejtpërdrejt apo tërthorazi, për partitë politike apo vet politikanët.

Përshkallëzimi dhe shkeljet

Zotëruesi i politikës apo institucioni duhet të raportojë shkelje të rëndësishme në përputhje me politikën e palëve të interesit apo procedurave të brendshme dhe jo vetëm:

- Për kontributet direkte ose indirekte për të gjitha palët e atakuara direkt apo tërthorazi

Rishikimi

Përgjegjësia për menaxhimin e politikës qëndron në qëndrueshmërinë e grupit, marrëdhëniet me palët e interesit, komunikimin, marketingun dhe rishikohet sipas procedurave të KRK-së, çdo vit.

5. Aprovimi dhe Hyrja në Fuqi

Kjo Politikë është miratuar nga Bordi i Drejtorëve të KRK-së dhe hynë në fuqi në datën e miratimit/ nënshkrimit nga Bordi i Drejtorëve.

Dokumenti i nënshkruar nga Bordi i Drejtorëve, do t'i shpërndahet të gjithë stafit përkatës të KRK-së. Përgjegjësia përfundimtare për ekzekutimin e kësaj politike bie mbi CEO-në e KRK-së.

Ky dokument i aprovuar nga Bordi i Drejtorëve zëvendëson të gjitha dokumentet tjera të lidhura me Politikën e Menaxhimit Mjedisor dhe Social.

Kjo Politikë është në përputhje me rregulloret e BQK-së, ligjet në fuqi dhe dokumentet tjera të brendshme të KRK-së.

Data e aprovimit: 16.10.2024 Kryesuesi i Bordit në emër të Bordit të Drejtorëve_____